



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:189369

Datë: 16.05.2023

Numri i dokumentit: 04283848

PKR.nr.114/2022

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Gjimshit Galushi dhe Nazim Vllaço, si anëtarë, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, në lëndën penale kundër të akuzuarve C.M., dhe R.K., të dytë nga Mamusha, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 nënpar.3.1 të KPRK, duke vendosur lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.226/20 të dt.08.05.2023, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, DKR PP/I.nr.226/20 të dt.31.12.2020, gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, av.F.J., dhe av.N.K., më 8.5.2023, mori këtë

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit

C.M., nga i ati dhe ëma, e lindur, i lindur mënë Mamush ku edhe tani jeton, me numër personal, ka të kryer fakultetin për letërsi turke, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, babai i pesë fëmijëve, ish drejtor i Drejtorisë së Arsimit në KK-Mamushë, pensionist, turk, shtetas i Republikës së Kosovës, më herët i pa dënuar.

R.K., nga i atidhe ëma, e lindur,i lindur më dt.në Mamushë ku edhe tani jeton, me numër personal, ka të kryer fakultetin pedagogjik, i punësuar, drejtor i shkollës së mesme të lartë “Ataturk” në KK-Mamushë, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, turk, shtetas i Republikës së Kosovës, më herët i pa dënuar.

JANË FAJTORË

I. Se në periodën kohore prej 01.11.2020 deri më 23.11.2020 në Mamushë, të akuzuarit C.M., në cilësinë e personit zyrtar –drejtor i Arsimit KK Mamush dhe R.K., në cilësinë e drejtorit të shkollës “Ataturk” kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar dhe i tejkalon kompetencat e tyre me qëllim që të shkelin të drejtat e personit tjetër R.Sh., ashtu që me dashje nuk e zbatojnë ligjin lidhur mbi punësimin, në atë mënyrë që të akuzuarit themelojnë marrëdhënie pune me

mësimdhënësit K.M., dhe F.M., në shkollën e mesme “Ataturk”, si dhe i akuzuari i parë C.M., themelon marrëdhënie pune edhe në shkollën fillore “Anadolu” me mësimdhënësen H.Q., dhe në shkollën “Zybejde Hanem” me mësimdhënësin Sh.M. pa u zhvilluar procedura e konkursit për punësim dhe është në kundërshtim të plotë me ligjin e punës 03/L- 212 neni 8.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 lidhur me par.3 nënpar.3.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të nenit 230 par.2 të KPPRK, neneve 7, 8, 9, 10, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 72, KPRK dhe nenet e përmendura më lartë, i

G J Y K O N

- të akuzuarin C.M., me dënim me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj
- të akuzuarin R.K., me dënim me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,

Në bazë të nenit 44 të KPRK, me pëlqimin e të akuzuarve,

- të akuzuarit C.M., dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1700 € (njëmijeshtatëqind euro);

- të akuzuarit R.K., dënimi me burg në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1700€ (njëmijeshtatëqind euro);

Obligohen të akuzuarit që dënimet me gjobë t’i paguajnë në tri këste mujore edhe atë prej datës 1-5 të secilit muaj, duke filluar 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë apo nuk mund të paguajnë dënimet me gjobë, gjykata do t’i zëvendësojë dënimet me gjobë me dënime me burg, ashtu që për çdo 20€ të dënimit me gjobë do të caktojë një ditë burg.

I dëmtuari R.Sh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor secili të paguajë shumën nga 100€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajë secili shumën prej 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.226/20 me dt.31.12.2020, kundër të akuzuarve C.M., dhe R.K., të dytë nga Mamusha,

për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 nënpar.3.1 të KPRK.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 19.04.2023, mbrojtësi i të akuzuarit C.M., av.F.J., ka njoftuar gjykatën se në konsultim me të mbrojturin e tij kanë vendosur që në këtë çështje penale pranë Prokurorisë së shtetit të parashtrinë kërkesë për hyrje në negociata për pranimin e fajësisë e cila parashtrësë është dërguar në Prokurori më 18.04.2023.

Me fjalën e avokatit është pajtuar dhe mbrojtësi i të akuzuarit R.K., i cili e mbështeti propozimin e dhënë.

Prokurori i shtetit ka pohuar se ka pranuar kërkesën për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe është duke u shqyrtuar kërkesa, andaj nga gjykata ka kërkuar një afat të arsyeshëm ligjor për negociimin e marrëveshjes.

Me datë 08.05.2023, pranë kësaj gjykate është pranuar marrëveshja mbi pranimin fajësisë PP/I.nr.226/20, e cila është shqyrtuar po në të njëjtën ditë pasi tashmë ka qenë e caktuar seanca për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor.

Në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të akuzuarit pas njoftimit me të drejtat të cilat u takojnë sipas ligjit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i Shteti propozoi që marrëveshja e arritur me këtu të akuzuarit C.M., dhe R.K., në prezencën e mbrojtësve të tyre, av.F.J., dhe N.K., të aprovet në tërësi, sepse marrëveshja është negociuar pa presion, pa premtime, pasi paraprakisht kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë se do të dënohen dhe se marrëveshja është nënshkruar në prezencën e mbrojtësve, andaj qëndron pranë rekomandimit për dënime.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.M.Sh., deklaroi se pasi janë njoftuar nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren se të akuzuarit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe pas analizimit të së njëjtës, ia lë gjykatës në vlerësim nëse e njëjta është hartuar në përputhje me ligjin në mënyrë që ta aprovojë si të tillë.

Mbrojtësi i të akuzuarit C.M., av.F.J., , deklaroi se marrëveshja është lidhur me pëlqimin dhe vullnetin e lirë të të akuzuarve, pa u shtyrë nga askush, e kanë pranuar përgjegjësinë penale për veprën e cila u ngarkohet, kanë shprehur pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se në të ardhmen do të përmbahen nga veprat e ngjashme penale. Marrëveshjen në fjalë sot në Prokurorinë Themelore në Prizren e kanë nënshkruar të akuzuarit bashkë me mbrojtjen, Prokurorin e shtetit dhe Kryeprokurorin e shtetit dhe nisur nga të lartcekurat, nga marrëveshja dënimi i rekomanduar është burgim në kohë zgjatje prej 5 (pesë) deri në 6 (gjashtë) muaj, me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë në shumën prej 1600€ deri 1800€, prandaj nisur nga ky fakt mbrojtja i propozon trupit gjykues që të marrë parasysh se i mbrojturi i tij është pensionist dhe realizon një pension minimal, po ashtu se edhe të ardhurat e të mbrojturit të kolegut të tij, të akuzuarit R.K., janë minimale, andaj propozon që të mbrojturve të tyre tu shqiptohet minimumi i dënimit të rekomanduar me marrëveshje.

I akuzuari C.M., deklaroi se pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij duke shtuar se pensioni është në vlerë prej 100€ dhe pendohet për veprimet e veta.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.K., av.N.K., , deklaroi se pajtohet në tërësi me të gjitha pretendimet dhe deklaratimet e dhëna nga parafolësi, av. Fatmir Jelliqi dhe dëshiron të shtojë se që nga momenti kur ka paraqitur kërkesën me shkrim për negocimin e marrëveshjes janë dakorduar me të mbrojturin e tij R.K., për pasojat lidhur me veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se i njëjti është pënduar për faktin se ka rënë ndeshë me ligjin dhe tani deklaron se në të ardhmen do të ketë kujdes për veprimet e veta me qëllim që të jetë person zyrtar, është hera e parë që ka rënë ndeshë me ligjin dhe në tërësi e pranon marrëveshjen e arritur pranë Prokurorisë me vullnet të lirë.

I akuzuari R.K., deklaroi se pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij, pendohet për veprimet e veta dhe premtonte se në të ardhmen nuk do të bie në konflikt me ligjin.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të Prokurorit të Shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tyre, se të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat në rastin konkret paraqiten në aktakuzë dhe të cilat pranohen edhe nga të akuzuarit dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 248 të KPRK, për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka pranuar në tërësi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/L.nr.226/20 të dt.08.05.2023, të lidhur ndërmjet Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda dhe të akuzuarve, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 nënpar.3.1 të KP-së. dhe ka konstatuar se të akuzuarit janë fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohen dhe i ka dënuar sipas rekomandimit të prokurorit, me dënim me gjobë duke konsideruar se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 70, 71 dhe 72 të KPRK, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese ka pasur parasysh që secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat e tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit. Në rastin konkret ka gjetur si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikun shoqëror dhe shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur duke pasur parasysh se pasojat e veprës prekin në dinjitetin e njeriut me qëllim që të dëmtojë ka mbetur pa punë, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, rrethanat personale se i akuzuari C.M., tani është pensionist, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale dhe se kanë pranuar veprën penale, prandaj gjykata ua shqiptoi dënimin me gjobë, duke konsideruar se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 të KPPRK.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 457 të KPPRK.

Vendimi mbi kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekur më lartë është vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.114/22 të dt.08.05.2023

Zyrtar ligjor
Kujtesa Uka

Përkthyesi gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.